

Kryetari i Komunës së Ulqinit, me vendim numër 01-082/23-1845/2 të datës 03.11.2023, ka konfirmuar Projekt planin për objektet e përkohshme në territorin e Komunës së Ulqinit për vitin 2024-2028, si dhe ka obliguar Sekretariatit për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm që të realizojë shqyrtimin publik.

Projekti del në:

## SHQYRTIM PUBLIK

Me rastin e draft planit për objektet e përkohshme Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit organizon dhe realizon shqyrtimin publik, i cili do të zgjasë 15 ditë.

Shqyrtimi publik i Projekt planit do të zgjasë prej datës 06.11.2023 deri më 21.11.2023.

Projekt Plani do të publikohen në ueb sajtin e Komunës së Ulqinit: [www.opstinaulcinj.com](http://www.opstinaulcinj.com)

Qasja publike në Projekt planin mund të bëhet në ambientet e Sekretariatit për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm, çdo ditë pune prej orës 11:00 deri në orën 13:00.

Shqyrtimi qëndror publik për Projekt planin do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, të premtën, më 17.11.2023 duke filluar:

në ora 13,00 – Plani i objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Ulqinit për vitin 2024-2028.

Vërejtjet, propozimet dhe sygjërimet dorëzohen me shkrim në adresën:

Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit, ose në e-mail: [urbanizam.ul@t-com.me](mailto:urbanizam.ul@t-com.me), deri më datë 21.11.2023.

Sekretariati për planifikim hapësinor dhe zhvillim të qëndrueshëm i Komunës së Ulqinit do t'i shqyrtojë vërejtjet, propozimet dhe sygjërimet e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik, pas të cilit do të hartojë raporte të veçanta për shqyrtimin e realizuar publik, i cili do të jetë pjesë përbërëse e materialit për mbledhjen e Kuvendit.

Numër: 05 - 382/23 - 1064/3  
Ulqin, më. 03.11.2023



U. D. SEKRETARIT

Shkëlzen Sulejmanaj, dip.ing.arh.